



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS ART PAMOR NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Material në ndihmë të mësuesit

2023

Koordinoi hartimin e udhëzuesit

Marina Topulli, ASCAP

Koordinoi redaktimin shkencor

Dr. Gerti Janaqi

Dr. Dorina Rapti

Koordinoi redaktimi letrar

Miranda Kurti

Koordinoi faqosjen

Eriksen Mersinllari

Prodhim i ASCAP, 2023

www.ascap.edu.al

Copyright ©, ASCAP

Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës “Art pamor” në arsimin e mesëm të lartë është produkt i konsultimeve dhe i diskutimeve me mësues dhe me specialistë të kësaj lënde në këtë cikël shkollimi.

TABELA E PËRMBATJES

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS TEATËR	5
1.1 Qëllimi i udhëzuesit	5
1.2 Përdoruesit e udhëzuesit	5
1.3 Struktura e udhëzuesit	5
II. RËNDËSIA E LËNDËS SË ARTIT PAMOR.....	6
2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e artit pamor	7
2.2 Risetë e lëndës së artit pamor	7
2.3 Shtrirja e lëndës së artit pamor	10
III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS ART PAMOR.....	10
IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR.....	15
V. TEMAT NDËRKURRIKULARE	17
VI. METODOLOGJIA MËSIMDHËNIE – NXËNIE NË ARTIN PAMOR.....	19
6.1 Stilet e të nxënit	20
6.1.1. Stili i të nxënit pamor.....	20
6.1.2. Stili i të nxënit dëgjimor.....	21
6.1.3. Stili i të nxënit kinestetik.....	21
6.2. Teknika të mësimdhënies	21
6.2.1. Brainstorming (stuhi mendimesh)	21
6.2.2 Diskutimi	22
6.2.3. Eksperimenti.....	22
6.2.4. Puna në grup	23
6.2.5. Kujtesa pamore	23
6.2.6. Hulumtimi i orientuar.....	23
6.2.7. Hulumtimi i lirë	23
6.2.8. Organizuesit grafikë.....	23

6.2.9. Teknika: Diagrami i Venit.....	24
6.2.10. Teknika: Kllasteri.....	25
6.2.11. Teknika: Harta e të pyeturit.....	27
6.2.12. Vlerësimi i veprave të artit dhe Kritika e artit.....	28
Vlerësimi i veprave të artit dhe Kritika e artit.....	28
6.2.13. Teknika “Përdorimi i teknologjisë/internetit.....	29
VII. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR	29
7.1 Llojet e planifikimeve	29
7.2 Planifikimi vjetor i lëndës.	30
7.3. Planifikimi sipas periudhave	32
7.4 Planifikimi ditor.....	39
VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN ART PAMOR	45
8.1. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë).....	46
8.2. Vlerësimi i të nxënit (Detyra përmbledhëse)	48
8.2.1 Shembull – Detyrë përmbledhëse, konkurs midis skuadrave.....	49
8.2.2. Shembull - Detyrë përmbledhëse, Ekspozitë	55
8.3. Projekti.....	57
8.3.1 Përshkrimi i produktit të projektit.....	63
8.3.2 Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi	65
8.4 Vlerësimi periodik	65
8.5 Vlerësimi përfundimtar	65
8.6. Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta	67
IX. KRITERET DHE REFLEKTIMI PËR DETYRA TË NDRYSHME NË LËNDËN E ARTIT PAMOR, AML.....	67
9.1. Kriteret për kryerjen e detyrave.....	67
9.2. Reflektimi i mësuesit	68

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS TEATËR

1.1 Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi lëndor i lëndës së artit pamor për arsimin e mesëm të lartë, trajton në mënyrë më të thellë të gjitha aspektet e kurrikulës që nga planifikimi i saj, metoda të mësimdhënies, metoda të të nxënësve, vlerësimin e të nxënësve në kontekstin e zhvillimit të kompetencave gjatë zbatimit të programit të artit pamor, e cila zhvillohet si lëndë me zgjedhje në AML klasat 10 - 12. Në këtë udhëzues janë kombinuar të gjitha materialet në zbatim të kurrikulës me kompetenca, me eksperiencën dhe praktikën më të mira të mësuesve në shkollë.

1.2 Përdoruesit e udhëzuesit

Udhëzuesi u vjen në ndihmë punonjësve arsimorë në sistemin e arsimit parauniversitar dhe si i tillë përdoret:

- nga mësuesit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, prindërit të cilët punojnë së bashku për të përmirësuar cilësinë e të nxënësve dhe rezultateve të nxënësve në lëndën e artit pamor;
- nga të gjitha institucionet arsimore në varësi të MAS-ë, njësitë arsimore vendore për zhvillimin profesional, këshillimin, vëzhgimin, monitorimin, kualifikimin e punonjësve arsimorë;
- nga institucionet e arsimit të lartë që përgatisin mësues në lëndën e artit pamor, të cilët mund t'i referohen për formimin fillestar mësuesve të rinj.

1.3 Struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi kërkon të japë përgjigje për një sërë pyetjesh dhe çështjesh të ngritura nga drejtuesit e shkollës, mësuesit, nxënësit, prindërit të cilët herë pas here kanë dilemat e tyre në lidhje me zbatimin e kurrikulës me kompetenca në lëndën e artit pamor.

Në këtë panoramë sfidash, një vend të veçantë merr *progresi i nxënësit* në zotërimin e artit pamor. Ajo që kuptojmë me progresin, a pajtohet me atë që ne kuptojmë me konceptin e zotërimit të artit pamor? Kjo është e lidhur ngushtë me një tjetër sfidë, disi më e gjerë, *problemi i vlerësimit*. Problemi i vlerësimit përbëhet nga dy çështje:

- së pari, është çështja e interpretimit në mënyrë të vlefshme dhe të besueshme e vlerësimit, të cilën ne e perceptojmë si një nga komponentët kyç të zotërimit të artit pamor. Kjo lidhet me hartimin dhe miratimin e instrumenteve të vlerësimit që matin njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në artin pamor. Përdorimi i këtyre instrumenteve nuk duhet të çojë në rezultate të gabuara kur ne nxjerrim konkluzione rreth zotërimit të kompetencës pamore të nxënësve. Problemi më i

madh këtu është se instrumentet mund të manipulohen duke prodhuar rezultate të pavërteta, kryesisht për shkak të vlefshmërisë së pamjaftueshme që sakrifikohet shpesh për të mirën e besueshmërisë;

- së dyti, është çështja e mospërputhjeve të shpeshta ndërmjet tre komponentëve: *I) mënyrave të vlerësimit; II) qëllimeve të lëndës; III) formave të mësimdhënie - nxënies në art pamor.*

Sigurisht ka edhe shumë sfida dhe probleme të tjera, por ristrukturimi i sistemit të formimit në artin pamor bazuar në parimet bazë të të mësuarit të artit pamor, ndërmjet të cilave është: *“Të gjithë nxënësit janë të aftë të nxënë artin pamor dhe të krijojnë duke përdorur gjuhën e tij specifike”.*

II. RËNDËSIA E LËNDËS SË ARTIT PAMOR

Arti pamor është pjesë e rëndësishme e kurrikulës dhe pjesë integrale e jetës sonë të përditshme, në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndër veprojnë kultura dhe shoqëria. Lënda e artit pamor është pjesë e kurrikulës që nga parashkollori deri në arsimin e mesëm të lartë që përfshijnë 6 shkallët e kurrikulës nga shkalla e parë deri në shkallën e gjashtë.

Arti pamor është një disiplinë artistike e artit dhe gjuhë universale që ndihmon nxënësin të kuptojë dhe lidhë fenomenet dhe dukurit pamore, proceset, teknikat dhe çështjet që i përkasin artit pamor, duke i parë të lidhura ngushtësisht me mjedisin dhe me jetën, gjë e cila çon drejt realizimit të një procesi krijues dhe analizues të suksesshëm në këtë fushë të artit.

Vazhdimi i rrugëtimit të njohjes me artin pamor është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të vëzhguar në mënyrë të pavarur e sistematike vepra të ndryshme arti, si dhe për të menduar dhe gjykuar në mënyrë kritike rreth tyre.

Arti pamor nuk mund të kuptohet dhe realizohet duke marrë vetëm disa njohuri, por duke vazhduar njohjen më të plotë të saj përmes gjuhës pamore dhe komunikimit nëpërmjet saj, të njohjes me veprat artistike, teknikat dhe proceset nëpër të cilat zhvillohet arti pamor, realizuar kjo nëpërmjet vëzhgimit, interpretimit, analizës të veprave dhe fenomeneve artistike pamore, njohjes me zhvillimin historik të artit pamor, njohuri që bëjnë të vetëdijshëm nxënësin për rolin e këtij arti në jetën e përditshme dhe vlerësimin e saj nëpërmjet një gjuhe të saktë artistike pamore.

2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e artit pamor

Arti pamor është pjesë e pandarë në një numër të madh të aktiviteteve të përditshme ku megjithëse zbatimet e saj janë nga më të ndryshmet, ato nuk mund të kuptohen pa marrjen e disa njohurive themelore të elementeve dhe parimeve kryesore e cila ka të bëjë me gjuhën me të cilën komunikon arti pamor. Gjuha pamore e bën të vetëdijshëm nxënësin për rolin e artit pamor në jetën e përditshme, duke zgjeruar botëkuptimin e tij.

Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënit të lëndës së artit pamor është të inkurajojë dhe t'u mundësojë nxënësve:

- të vlerësojnë vlerat e artit shqiptar për ta ruajtur dhe për ta kultivuar identitetin kombëtar;
- të zhvillojnë aftësitë e përjetimit *estetik dhe vlerësimit kritik*.
- të vlerësojnë artin pamor në periudha të ndryshme historike duke zhvilluar aftësitë vëzhguese, interpretuese, analizuese;
- të zhvillojnë aftësitë e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit ndërmjet kulturave duke ndërvepruar në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupe të ndryshme kulturore apo etnike;
- të kuptojnë forma të ndryshme të veprimtarisë pamore duke zhvilluar aftësitë krijuese, individuale;
- të zhvillojnë kompetencat pamore për të krijuar dhe realizuar punime të ndryshme artistike në mënyrë të pavarur;
- të marrin pjesë në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke vënë në shërbim të mjedisit, ku jeton, aftësitë dhe talentin e vet;
- të japin kontributin personal në zhvillimet artistike pamore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.
- të japin kontributin personal në veprimtaritë artistike pamore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

2.2 Risitë e lëndës së artit pamor

- Ndryshimi i emërimit të programit nga “Edukim figurativ” në “Art pamor”.
- Unifikimi i tematikave dhe kompetencave të njëjta me të gjitha lëndët brenda fushës së arteve.
- Ndërtimi i programeve lëndore bazuar në kompetencat e fushës, të cilat mbështetin dhe zhvillojnë kompetencat kyçe.

- Zhvillimi i veprimtarive krijuese nëpërmjet situatave të nxënësve.

Risite në përmbajtje

Programi i Artit pamor, nëpërmjet përmbajtjes të përcaktuar sipas tematikave, ka si qëllim formimin e një identiteti personal të vetëbesimit dhe ndihmon në krijimin e vetëdijes kulturore dhe ndjeshmërisë artistike. Nxënësit kanë mundësi të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën vizuale, për të komunikuar mendimin e tyre për një audiencë të caktuar. Në këtë nivel ata mësojnë të analizojnë dhe të zhvillojnë ndjesitë e tyre estetike nëpërmjet vlerësimit jo vetëm të punëve të tyre dhe të shokëve/shoqeve, por edhe të veprave të artit, të fakteve dhe imazheve të marra nga historia dhe trashëgimia kulturore e së tashmes dhe e së shkuarës. Nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxënësit inkurajohen të bëjnë lidhjen e artit pamor me lëndët e tjera në kurrikul dhe ta shohin artin si një mundësi karriere.

Tabela 1: Kompetencat e artit pamor

Kompetenca	Treguesit
Kompetenca: Krijimi artistik Kjo kompetencë ka të bëjë me kuptimin dhe përdorimin e gjuhës artistike pamore duke zhvilluar aftësitë krijuese individuale por edhe në grup.	Disa tregues kryesorë janë: ▪ shpjegon se si estetika reflektohet në jetën e përditshme; ▪ diskuton mbi artin duke u nisur nga disa qëndrime estetike; ▪ krijon punime arti dy dhe tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të larmishëm të gjuhës pamore; ▪ komunikon ide origjinale nëpërmjet krijimeve me teknika të larmishme; ▪ analizon dhe organizon elementët dhe parimet e artit në krijim; ▪ analizon veprën e artit duke i'u referuar elementeve dhe parimeve; ▪ analizon eksperiencat krijuese dhe identifikon se çfarë ka mësuar nga ato; ▪ zbulon përmbajtjen e veprave të artit dhe analizon elementët e gjuhës pamore.

Kompetenca: realizimi i punimit Kjo kompetencë ka të bëjë me zhvillimin e aftësive krijuese, nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike 2 dhe 3 dimensionale.	on nivel të lartë në përdorimin e teknikave të e artistike gjatë krijimit; on aftësi krijuese gjatë realizimit të punimeve si t vëzhgimit direkt nga natyra edhe nëpërmjet ë tij/saj mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet ës; on aftësi në seleksionimin, përgatitjen dhe n e punimit; dhe organizon materialet, gjuhën pamore në tij/saj origjinale; eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton n e tjetrit.
Kompetenca: Vlerësimi i veprave të artit Kjo kompetencë ka të bëjë me kuptimin, gjykimin dhe vlerësimin e veprave të artit pamor duke i njohur ato në hapësirë dhe në kohë përmes historisë dhe artistëve përfaqësues, bazuar në kontekstin historik, artistik, politik në të cilën është krijuar vepra.	Disa tregues kryesorë janë: ▪ vlerëson veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik; ▪ zhvillon aftësitë vlerësuese dhe kritike ndaj veprave të artit nëpërmjet mendimit estetik; ▪ identifikon dhe kategorizon veprat e artit sipas teknikës, periudhës, stilit dhe artistit; ▪ demonstroi aftësi gjatë përshkrimit, analizës, interpretimit dhe vlerësimit të veprës së artit; ▪ tregon interes ndaj komenteve të të tjerëve; ▪ respekton shumëllojshmërinë e opinioneve estetike dhe kritike; ▪ diskuton rreth çështjeve dhe problemeve të artit sot.

2.3 Shtrirja e lëndës së artit pamor

Sipas Kornizës së Kurrikulës së Shqipërisë dhe planit mësimor ndarja e kohës mësimore për arsimin e mesëm të lartë (AML), fusha e arteve zhvillohet me 6 orë mësimore/javore. Në shkallën e pestë dhe të gjashtë të kurrikulës, artet zhvillohen, në kurrikulën me zgjedhje klasat 10,11,12-të, artet zhvillohet me 2 orë:

- Art pamor 2 orë
- Muzikë 2 orë
- Teatër 2 orë

Lënda e artit pamor zhvillohet për 36 javë mësimore me nga 2 orë mësimore secila (45 minuta), pra gjithsej 72 orë. Lënda e artit pamor zhvillohet përmes tre tematikave përmbajtjesore: *Gjuha dhe komunikimi artistik (GJKA)*, *Teknika dhe procese artistike (TPA)* dhe *Historia, arti dhe shoqëria (HASH)*.

Megjithëse njohuritë përcaktohen për secilën tematikë, ato mund të trajtohen të integruara me njëra-tjetrën. Brenda shumës së orëve të lëndës art pamor, mësuesi planifikon të gjitha veprimtaritë që do të organizojë për një mësimdhënie – nxënie sa më efektive (si përmbajtja sipas programit, projekti, apo edhe veprimtari të tjera në ndihmë të përparimit të nxënësit).

Tabela 2: Tabela përmbledhëse e peshave për secilën tematikë.

KLASA	TEMATIKAT			GJITHSEJ ORË
	GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK	TEKNIKA DHE PROCESE ARTISTIKE	HISTORIA, ARTI DHE SHOQËRIA	
Klasa 10,11 ose 12-të	15	20	37	72 orë

III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS ART PAMOR

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënies. **Kompetenca** përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.

Organizimi i mësimit në art pamor me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

Kur nxënësit realizojnë kompetencat e lëndës së artit pamor, ata njëkohësisht janë duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh.: kompetenca e artit pamor “krijimi artistik” përfshin përdorimin e elementeve të artit në një punim artistik për të shprehur dhe komunikuar ide dhe mendime, gjë e cila përkon plotësisht me kompetencat kyçe të “komunikimit dhe të shprehurit”, “kompetencën e të menduarit.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të artit pamor pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë.

Gjatë ndërtimit të kompetencave të artit pamor: **krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i i veprave të artit**, nxënësit ndërtojnë edhe kompetencat kyçe si: P.sh. kompetenca e artit pamor “krijimi artistik” përfshin njohuritë mbi gjuhën vizuale të cilat nxënësi i zbulon në objektet, mjedisin që e rrethon, në veprat e artit, duke i përdorur ato në krijimet e veta për të shprehur ndjenja e mendime të realizuara përmes teknikave artistike dhe zgjidhur problemet në detyrën e tyre në mënyrë të pavarur. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës së artit pamor pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë. Në zhvillimin e kompetencave të artit pamor nxënësi gjithashtu zhvillon kompetencat kyçe në lidhje me krijimtarinë, realizimin, vlerësimin e artit pamor, përpunimin e informacionit për veprat e artit, prezantimin e detyrave të zhvilluara, punën në grup, komunikimin efektiv etj. Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së artit pamor mësuesi ndjek këto hapa:

- *përzgjedh* rezultatin/et e të nxënit nga kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- *zberthen* në rezultate të nxëni për kompetenca kyç për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- *përzgjedh* rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e lëndës së artit pamor që synon të arrijë nxënësi;
- *zberthen* në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës së artit pamor për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë;
- *përzgjedh* përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të artit pamor në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;

- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënësve brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecures së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënësve për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e artit pamor.

Shembull: Kompetencat kyçe dhe kuptimi i tyre.

SHKALLA E PESTË
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Nxënësi: - zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike të krijimit, realizimit dhe analizimit të veprave të artit; - ----- - ----- - -----
Kompetenca e të menduarit
Nxënësi : - përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; - ----- - -----
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Nxënësi : - ----- - përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një punë të vetën mbi artin në përgjithësi apo artin pamor në veçanti; - -----
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
Nxënësi : - zhvillon aftësitë menaxhuese artistike lidhur me një projekt artistik; - -----

- -----
Kompetenca personale
Nxënësi : - krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë veprimtarive artistike; - ----- - -----
Kompetenca qytetare
Nxënësi : - promovon me qytetari, vlerat të ndryshme kulturore dhe artistike të vendit apo të krahinës; - ----- - -----
Kompetenca digjitale
Nxënësi : - ----- - Përdor dhe njeh mjete të ndryshme në funksion të informacionit artistik si: audio, video CD, DVD, aparat fotografik digjital, kamera, etj.

Shembujt e mëposhtëm të zhvillimit të kompetencave kyç nëpërmjet zhvillimit të kompetencave të artit pamor dhe përmbajtjes së lëndës nuk janë shteruese. Ato pasurohen nga vetë mësuesit.

Kompetencat kyç “Komunikimi dhe të shprehurit” dhe “Të menduarit” të cilat zhvillojnë te nxënësit të kuptuarin e mesazheve që u drejtohen, të shprehen në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, të përpunojnë në mënyrë të pavarur, kritike, ndërvepruese dhe krijuese informacionin mund të lidhet mjaft mirë me kompetencat e artit pamor “Krijimi artistik”, “Realizimi i punimit” dhe “Vlerësimi i veprave të artit”.

Shembull 1: Kur nxënësit krijojnë ata komunikojnë një mendim dhe e shprehin atë nëpërmjet përdorimit të gjuhës vizuale dhe teknikave të ndryshme artistike. Gjithashtu gjatë krijimit ata zgjidhin probleme të ndryshme artistike dhe zhvillojnë mendimin kritik. Në temën mësimore “Kolazh me fotografi” nxënësit përzgjedhin vetë imazhet fotografike sipas temës. Nëpërmjet përzgjedhjes së fotografive dhe realizimit të kolazhit ata mbajnë edhe qëndrim kritik duke

vlerësuar ato që lidhen më shumë me idenë e tyre. Edhe gjatë vlerësimit të punimeve të tyre apo të shokëve ata shprehin qëndrimin e tyre.

Kompetenca kyç “Të mësuarit për të nxënë”, e cila i krijon nxënësve mundësitë për të përzgjedhur mjetet për të realizuar një krijim artistik dhe përgatitet për të nxënëit gjatë gjithë jetës mund të lidhet më së miri me kompetencat pamore.

Shembull 2: Në temën mësimore “Dizajni i çantës nëpërmjet teknikës së stampimit” nxënësit zgjedhin vetë cilin nga llojet e stampimit do të përdorin, Ata përdorin burime të ndryshme për të zgjedhur motivin sipas idesë dhe e realizojnë në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca kyç “Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin”, e cila zhvillon te nxënësi shpirtin sipërmarrës, ndërmarrjen e iniciativave mund të lidhet me kompetencat e artit pamor. Një ilustrim konkret mund të jetë një temë mësimore që lidhet me problematikat e ndërtimeve pa kriter dhe impaktin vizual që krijon ajo.

Shembull 3: në temën mësimore “Si ta përmirësojmë urbanistikën e lagjes ku jetojmë” nxënësit nxiten të shohin me sy kritik lagjen e tyre për të gjetur gjërat që nuk shkojnë në lidhje me ndërtesat, hapësirat e gjelbërta, mungesën me hapësirat e nevojshme për komunitetin. Ata ftohen të reflektojnë dhe të shprehin nëpërmjet artit për të dhënë idetë e tyre mbi përmirësimin e këtij mjedisi.

Kompetencat kyç “Personale” dhe “Qytetare”, të cilat zhvillojnë te nxënësi vetëbesimin, vetëvlerësimin, besimin te të tjerët, bashkëjetesën sociale si qytetarë të përgjegjshëm mund të lidhet shumë mirë me kompetencat e artit pamor. Një ilustrim konkret mund të jetë një veprimtari punë në grup, (qoftë projekt, ekspozitë apo konkurs me dy skuadra).

Shembull 4: Në temën mësimore “Ekspozita” nxënësit përfshihen në mënyrë aktive në përzgjedhjen e punimeve, bashkëpunojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin. Ky bashkëpunim sjell edhe vetëbesimin dhe krijon besimin te të tjerët kur puna ndahet në mënyrën e duhur dhe sipas aftësive të gjithwsecilit. Gjithashtu gjatë punës ata diskutojnë së bashku për probleme të ndryshme artistike si: shpërndarjen e punëve, mënyrën e ekspozimit, mënyrën e realizimit etj..

Kompetenca kyç “Digjitale”, e cila zhvillon te nxënësi përdorimin efektiv të pajisjeve digjitale për të shkëmbyer, prodhuar, krijuar, prezantuar apo përpunuar informacionin mund të lidhet me kompetencat e artit pamor. Nxënësit realizojnë fotografi, apo kërkojnë imazhe ndihmëse për

krijimin e tyre, kërkojnë të dhëna për një artist apo një periudhë artistike, bëjnë prezantime të kërimit të tyre apo të krijimeve, etj..

IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Arti pamor është i lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Elementet e artit pamor, ritmi, harmonia, dinamika, etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike, si kërcimin, muzikën, teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën, shkencat shoqërore. Kështu që edhe në këtë cikël, mësuesit përmes mësimit të shumë përmbajtjeve mësimore, duhet t'u japin mundësinë nxënësve të konsolidojnë përvojat që ata kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave.

IV.1. Shembull: Lidhja e artit pamor me lëndët e tjera

Arti pamor: shkencat e natyrës dhe matematika

- Në temën “Format dy dhe tredimensionale” nxënësi identifikon dhe shqyrton kontrastin midis formës së nënkuptuar mbi sipërfaqen dy dimensionale dhe formës reale tre dimensionale. Këtë koncept nxënësit e përdorin për të paraqitur formën tredimensionale në sipërfaqen dy dimensionale të vizatimit dhe pikturës. Por përpara se të kalojë në procesin krijues nxënësit duhet të pajisen me njohuritë mbi këtë koncept. Në këtë rast na vijnë në ndihmë njohuritë e shkencave të natyrës të cilat i ndihmojnë nxënësit për të kuptuar shumëllojshmërinë e formave tredimensionale në natyrë dhe karakteristikat e ndërtimit të tyre. Gjithashtu matematika me njohuritë mbi format dhe trupat gjeometrike si dhe lidhjen e ngushtë mes tyre i nihmojnë nxënësit t'i pasqyrojnë sa më mirë ato si në krijimet dy ashtu edhe në ato tredimensionale.

Arti pamor: shkencat e natyrës, shkencat shoqërore dhe mjedisi

- Në temën “Trupi i njeriut në kompozim” konceptet e artit pamor janë “proportionet dhe trupi i njeriut”. Këto koncepte nxënësit i përdorin për të krijuar një kompozim ku personazhet të vendosen në raportet e duhura në marrëdhënie si midis pjesëve të trupit ashtu edhe mes trupit dhe hapësirës ku ndodhen. Përpara se të realizojnë punimin e tyre integrimi i njohurive të shkencave të natyrës (anatomia) mbi proporcionet e trupit të njeriut është më se i nevojshëm për të pasqyruar në mënyrën e duhur personazhet në krijimin e tyre. Gjithashtu i nevojshëm është edhe integrimi i njohurive të shkencave shoqërore dhe mjedisit, që ka lidhje me marrëdhëniet midis njeriut dhe mjedisit, apo midis njerëzve, me detyrat e tyre, me

profesionet, me mjedisin e shëndetshëm, etj.. Këto njohuri të shkencave shoqërore dhe të mjedisit do të shërbenin për të dhënë një mesazh të fortë edukativ dhe informues.

Arti pamor: Gjuhët dhe komunikimi

- Gjuhët dhe komunikimi, janë pjesë e një integrimi të përhershëm në lëndën e artit pamor. Kur nxënësit vlerësojnë punën e tyre apo të shokut ata komunikojnë nëpërmjet gjuhës, mbrojnë një argument apo e hedhin poshtë atë, shpjegojnë dhe analizojnë. Kërkimi i materialeve të ndryshme mbi artin pamor është pjesë e integritit gjuhësor, jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhë të huaja.

Tabela 3: paraqitja e disa lidhjeve të artit pamor me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.

ARTI PAMOR	GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK - Gjetja e të dhënave mbi periudha, vepra dhe autorë. - Përshtatja e njohurive artistike në nivele më të thjeshta. - Mbrojtja e një argumenti duke u bazuar në njohuritë artistike. - Shkrimi i një opinionit apo mendimi estetiko-artistik, përmes esesë ndaj një veprë arti.	Tema: “Analizë veprë” Lidhet me gjuhën nëpërmjet rezultatit: Shkrimi i një opinionit apo mendimi estetiko-artistik, përmes esesë ndaj një veprë arti.
	SHKENCAT SHOQËRORE DHE MJEDISI - Kultura. - Estetika - Identiteti kombëtar. - Trashëgimia kulturore.	Tema: Trashëgimia kulturore Lidhet me Qytetari nëpërmjet rezultatit: - Kultura.
	SHKENCAT E NATYRËS - Vija - Ngjyra - Forma	Tema: Elementet dhe parimet e artit Lidhet me Fizikën nëpërmjet rezultatit: - Natyra dhe ligjet e saj.

	- Tekstura - Harmonia - Ritmi - Baraspesha - Dinamika.	
	TIK - Mbledhja e informacionit mbi muzetë e artit nëpërmjet internetit. - Organizimi dhe përpunimi i informacionit të gjetur. - Analiza dhe interpretimi i informacionit. - Paraqitja dhe prezantimi i materialit	Tema: Muzeu i artit Lidhet me TIK nëpërmjet rezultatit: - Mbledhja e informacionit mbi muzetë e artit nëpërmjet internetit.
	EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI - Trupi i njeriut dhe lëvizja	Anatomia e lëvizjeve të njeriut në sporte

V. TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Arti pamor është shumë i pranishëm në veprimtaritë e jetës së përditshme dhe është i lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë sepse ajo, jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këta komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu temat ndërkurrikulare që duhet të zhvillohen janë:


- *Identiteti Kombëtar dhe njohja e kulturave;*
- *Të drejtat e njeriut;*
- *Vendimmarrja morale;*
- *Zhvillimi i qëndrueshëm;*
- *Mjedisi;*
- *Ndërvlerësia;*
- *Bashkëjetesa paqësore*

Për zhvillimin e këtyre temave mësuesi p.sh.: përforcon rëndësinë e *Identitetit Kombëtar*, duke e parë në bashkëpunim me njohuritë që kanë nxënësit nga lëndët e tjera. Nxënësi kontribuon përmes veprimtarive të artit pamor, duke shpalosur *vlerat e kulturës së vet, por edhe duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera*, si në punimet e veta personale, ashtu edhe duke bashkëpunuar në grup.

Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave të artit pamor me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave. Nxënësi përdor aftësitë e tij pamore që kanë të bëjnë me simbole, vizatime grafike për të zhvilluar një marrëdhënie aktive në mjedisin e tij. Ai mund të shpjegojë fenomenet dhe dukuritë pamore në botën e tij dhe ndërvlerësitë e mjedisit dhe botës njerëzore (format dhe ngjyrat).

Model me dy tema ndërkurrikulare

Dy skemat e mëposhtme, të sjella si shembull, tregojnë qartë lidhjen e njohurive të artit pamor dhe të muzikës me temat ndërkurrikulare: ***Bashkëjetesa paqësore dhe Identiteti Kombëtar***



VI. METODOLOGJIA MËSIMDHËNIE – NXËNIE NË ARTIN PAMOR

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të artit pamor do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë mjedisin vizual dhe krijojnë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar nëpërmjet rezultateve të të nxënës dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor, është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia në artin pamor, synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet ***në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar.***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete, etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- **kompetencat kyçe;**
- **ndërtimin e çdo njohurie dhe çdo aftësie** mbështetur në ato të mëparshmet;
- **veprimtari praktike krijuese** në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- **mjete dhe materiale** konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- **krijimin e qëndrimit pozitiv** ndaj lëndës së artit pamor dhe përdorimi i saj përgjatë gjithë jetës;
- **bashkëveprimin mësues-nxënës** gjatë procesit mësimor, duke qenë plotësues të njëri-tjetrit.

Mësimdhënës të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, te kujtesa, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënësve, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësve, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënësve dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënësve, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbushin detyra të rëndësishme të mësimdhënies dhe:

- Ruajnë *përfshirjen aktive*;
- Nxënësit *diskutimin e hapur*;
- Nxënësit të krijojnë dhe *të bëjnë pyetjet e tyre*;
- Ndihmojnë në *shprehjen e mendimeve* të nxënësve;
- Ruajnë *motivimin* e nxënësve për të mësuar;
- Sigurojnë një mjedis ku *respektohen mendimet*;
- Krijojnë një shtresë për *reflektim* në atë që nxënësit *vlerësojnë*;
- Shërbejnë si nxitje për *ndryshim*;
- Vendosin shpresë për *përfshirjen kritike* të nxënësve;
- Ndihmojnë *mendimin kritik* në nivele të larta e të ndërlikuara.

6.1 Stilet e të nxënësve

6.1.1. Stili i të nxënësve pamor

Përmes zbatimit të këtij stili të të nxënësve nxënësi përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast mësimi konkretizohet, duke përdorur mjete mësimore si: *foto, harta, fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, makete, ilustrime, vizatime, DVD (ku kemi dy lloj stilesh: pamore dhe dëgjimore) etj..* Të nxënësve përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një objekt, ngjarje, personazh, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore,
- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

Në stilin e të nxënësve pamor do të gruponim: *Kujtesën pamore; Organizuesit grafikë (teknikat: Diagramin e Venit, Kllasterin, Hartën e të pyeturit, etj..*

6.1.2. Stili i të nxënit dëgjimor

Përmes zbatimit të këtij stili të të nxëni nxënësi përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet *bisedave, diskutimeve* ku bëhen vlerësime, jepen mendime, përfundime, bëhen analiza etj.. Të nxënit përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e shpjegimit të njohurive apo një situatë në kontekstin e temës mësimore,
- biseda dhe diskutime në grup për prezantimin e punëve të ndryshme,
- veprimtari që kërkon të folur të rrjedhshëm dhe të qartë.

Në stilin e të nxënit dëgjimor do të gruponim: *Brainstorming; Diskutimi; Hulumtimi i orientuar.*

6.1.3. Stili i të nxënit kinestetik

Përmes zbatimit të këtij stili të të nxëni nxënësi përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke *vepruar, luajtur, shkruar, vizatuar* etj.. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

- e prekin dhe e ndjejnë përmbajtjen mësimore,
- ndërveprojnë me shokët dhe mësuesin,
- ndërveprojnë me mjetet e punës,
- përdorin gjuhën e ndjenjave.

Në stilin e të nxënit kinestetik do të gruponim: *Eksperimenti; Puna në grup; Hulumtimi i lirë dhe i orientuar; Vlerësimi i veprave të artit dhe kritika e artit.*


Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësimdhënës të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore, duke përdorur mjaft teknika dhe metoda të mësimdhënies.

6.2. Teknika të mësimdhënies

6.2.1. Brainstorming (stuhi mendimesh)

Mësuesit mund të përdorin brainstorming si një strategji (metodë) e të menduarit, për të ndihmuar nxënësit të gjenerojnë pyetje, ide dhe shembuj si dhe të zbulojnë një ide apo një temë qendrore (kryesore). Gjatë aplikimit të brainstorming, nxënësit ndajnë idetë që u vijnë në mendje dhe i regjistrojnë këto ide pa bërë gjykime rreth tyre. Mësuesi mund të përdorë këtë metodë gjatë prezantimit të temës (gjatë situatës së të nxënit), për të përcaktuar atë që nxënësit dinë dhe duan (ose duhet) të mësojnë dhe për të orientuar zhvillimin e mësimin dhe reflektimin. Brainstorming

stimulon të menduarit rrjedhshëm dhe fleksibël dhe gjithashtu mund të përdoret për të aftësuar nxënësit në zgjidhjen e problemeve artistike.



6.2.2 Diskutimi

Diskutimi është një strategji bashkëpunimi përmes së cilës nxënësit shqyrtojnë mendimin e tyre, reagojnë ndaj ideve, përpunojnë informacionin dhe artikulojnë mendimet e tyre duke i shkëmbyer me njëri-tjetrin dhe me mësuesit. Diskutimi mund të përdoret për të qartësuar konceptet, idetë dhe informacionin. Theksi vihet në bisedën dhe dëgjimin e njëri-tjetrit. Nëpërmjet diskutimit, nxënësit mund të krijojnë lidhje midis ideve dhe përvojës dhe të reflektojnë mbi interpretime të ndryshme.

6.2.3. Eksperimenti

Eksperimenti është një metodë thelbësore për artin pamor dhe përdoret shpesh për të bërë lidhjen midis konkretes dhe abstraktes. Eksperimentimi kërkon që nxënësit të hetojnë, testojnë, eksplorojnë, manipulojnë, zgjidhin problemet, marrin vendime dhe organizojnë informacione në mënyrë praktike. Eksperimentimi inkurajon gjithashtu nxënësit që të përdorin aftësitë bashkëpunuese në mënyrë efektive në interpretimin dhe komunikimin e gjetjeve. Eksperimentimi rrit motivimin, mirëkuptimin dhe përfshirjen aktive të nxënësve dhe mund të iniciohet nga mësuesi ose vetë nxënësi.

6.2.4. Puna në grup

Teknikat e punës në grup u mundësojnë nxënësve të punojnë si ekip për të arritur një qëllim të përbashkët mësimi. Për shembull, një grup nxënësish mund të punojnë së bashku për të krijuar një vepër arti ose për të realizuar një projekt artistik. Përveç produktit përfundimtar të prodhuar nga grupi, një aspekt i rëndësishëm i procesit të të mësuarit bashkëpunues është që çdo anëtar i grupit të shqyrtojë se si grupi funksiononte dhe të vlerësojë kontributin e tij ose të saj në procesin e punës në grup. Diskutimet, shënimet dhe vetëvlerësimi janë disa mënyra në të cilat nxënësit mund të reflektojnë mbi procesin e punës në grup dhe pjesën e tyre në të.

6.2.5. Kujtesa pamore

Kujtesa pamore është një proces që shërben për ta bërë një objekt, një ngjarje ose një situatë të dukshme në imagjinatën e nxënësve duke e ndërtuar nëpërmjet përshkrimit me fjalë ose duke përdorur një imazh. Mësuesit mund të përdorin imazhet, gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies, si një ushtrim për kujtesën dhe si një nxitës i rëndësishëm përpara krijimit të punimit. Mësuesit gjithashtu mund të përdorin një sërë stimulimesh pamore (p.sh., ilustrime, fotografi, riprodhime veprash arti, video, objekte reale, grafika) për të ndihmuar nxënësit në krijimin dhe realizimin e punimeve të tyre artistike nëpërmjet teknikave të ndryshme.

6.2.6. Hulumtimi i orientuar

Hulumtimi i orientuar është një metodë mësimore në të cilën nxënësit përdorin mjetet dhe materialet

sipas zgjedhjes së tyre. Mësuesi vëzhgon dhe dëgjon ndërsa nxënësit po eksplorojnë dhe japin udhëzime sipas nevojës, duke përdorur informacionin e mbledhur nga vlerësimi. Për shembull, mësuesi mund të parashtrojë një pyetje, që nxit një mendim më të thelluar ose të prezantojë një fjalor të ri.

6.2.7. Hulumtimi i lirë

Hulumtimi i lirë është një aktivitet kyç i mësimdhënies që iniciohet nga nxënësit, duke përdorur materialet artistike në klasë në mënyrat e zgjedhjes së tyre. Mësuesi vëzhgon dhe dëgjon si pjesë të vlerësimit të vazhdueshëm, ndërsa nxënësit eksplorojnë (hulumtojnë) lirisht, mësuesi nuk e drejton eksplorimin ashtu siç bën gjatë eksplorimit të orientuar.

6.2.8. Organizuesit grafikë

Përdorimi i organizuesve grafikë është një strategji veçanërisht e fuqishme e mësimdhënies. Grafikët, të konsideruar si një çelës pamor, u mundësojnë nxënësve të kuptojnë marrëdhëniet midis elementeve dhe organizimit të tyre në mënyrë pamore dhe jo vetëm nëpërmjet gjuhës, duke

e bërë më të shpejtë përthithjen e njohurive. Grafikët mund të përdoren për të regjistruar, organizuar, krahasuar, analizuar dhe sintetizuar informacionet dhe idetë. Ato mund t'i ndihmojnë nxënësit të lidhin njohuritë paraprake me konceptet e reja si dhe konsolidimin e kuptimit të tyre. Shembuj të përdorimit të grafikëve janë: Harta e pyetjeve (realizimi), harta e mendimeve (klasteri) (reflektimi), tabela e koncepteve (reflektimi), diagrami i Venit (përdoret gjatë reflektimit), afatet kohore (kryesisht në historinë e artit).


Përdorimi i tabelave grafike është jashtëzakonisht i dobishëm kur kryhet fillimisht si një aktivitet brainstorming i klasës apo grupit. Organizatori grafik ofron një mënyrë për të mbledhur dhe paraqitur në mënyrë vizuale informacion mbi një temë që do ta bëjë atë më të kuptueshëm për studentët.

6.2.9. Teknika: Diagrami i Venit

Diagrami i venit është një teknikë, më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve (elementeve të artit, teknikave artistike, periudhave të historisë së artit, veprave të artit të një periudhe, veprave të artit të periudhave të ndryshme, veprave të artit me të njëjtën tematikë, etj.. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësim, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to. Veprimtaria zgjat 10'-20', por është në varësi të temës, moshës dhe kohës së përgjithshme në dispozicion.

Teknika e akuareleve

Teknika e temperave



Tipare dalluese të

teknikës së akualetit
Akualet janë ngjyra
transparente.

Akualet punohen:

Me të lagur në të thatë
ose e lagur mbi të
lagur.

Në teknikën e akualetit
nuk përdoret e bardha.

Akualet punohet mbi
letër

Të përbashkëta

Janë të dyja teknika
të pikturës.

Quhen të dyja ngjyra
uji.

Peneli është një mjet
i rëndësishëm për të
dyja teknikat.

Tipare dalluese të

teknikës së temperave
Temperat janë ngjyra
mbuluese.

Në teknikën e temperave
përdoret ngjyra e bardhë
Tempera punohet mbi
letër, karton, telajo.

6.2.10. Teknika: Kllasteri


Kllasteri ose grupimi i mendimeve ose “harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, sidomos për ata nxënës që u mungon një dëshirë e tillë.

Hapat për realizmin e kllasterit janë të thjeshta dhe të lehta për t’u mbajtur mend:


- Shkruhet një fjalë në qendër të fletës, (dërrasës së zezë, apo sipërfaqes ku mund të shkruhet).
- Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mend rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Kur idetë vijnë në mend të kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për gabimet në shkrim apo në shqiptim.

Kjo teknikë mund të përdoret në fazën e evokimit dhe të reflektimit, në të gjitha lëndët dhe me çdo moshë nxënësish. Ajo mund të përdoret për të stimuluar të menduarit, përpara se të studiohet pjesa ose për të bërë përmbledhjen e asaj që është studiuar;


Shembulli 1.



Shembulli 2




Shembulli 3




6.2.11. Teknika: Harta e të pyeturit

Harta e të pyeturit është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit. Harta e të pyeturit mund të përdoret me sukses në fazën e realizmit të kuptimit dhe të reflektimit. Një hartë e të pyeturit mund të përdoret për të menduar rreth çdo lloj çështjeje ose teme, ose gjatë një mësimi për të gjallëruar diskutimin e nxënësve, për t'i mbajtur ata të interesuar rreth problemit dhe për të përmbledhur informacionin e trajtuar.



6.2.12. Vlerësimi i veprave të artit dhe Kritika e artit

Vlerësimi i veprave të artit dhe Kritika e artit janë të përshtatshme për të mësuarit në grup. E gjithë klasa mund të bashkëpunojë si një e vetme, pa përplasje dhe rrëmujë. Për shkak të mënyrës se si komentet e nxënësve lidhen dhe ndërtohen mbi njëri tjetrin, veprimtaritë mbi vlerësimin dhe kritikën e veprave të artit janë veçanërisht të përshtatshme për mësimdhënien si një grup i tërë klasës. Hapat e kritikës së artit janë: përshkrimi, analiza, interpretimi dhe gjykimi. Kjo është një metodë mësimore e bazuar në hulumtime që përmirëson të menduarit kritik dhe aftësitë gjuhësore nëpërmjet diskutimeve të imazheve vizuale.



6.2.13. Teknika “Përdorimi i teknologjisë/internetit

Teknologjia përfshin përdorimin e programeve kompjuterike artistike për realizimin e detyrave dixhitale, ndërsa interneti mund të përfshijë World Wide Web, postë elektronike (e-mail), etj. Është një burim i dobishëm informacioni për shumë tema dhe një mjet komunikimi me njerëzit. Nxënësi duhet të përdorë aftësi specifike të nevojshme për të kërkuar informacionin e duhur në internet dhe të vlerësojë në mënyrë kritike e informacionin e grumbulluar. Përdorimi i programeve të ndryshme si Paint, Photoshop, Exel për përpunimin e të dhënave është shumë e rëndësishme si në përpunimin e materialit por edhe në prezantimin e tij.

VII. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe i lirë në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën Kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësimor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënit janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Mësuesit përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t’u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

7.1 Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën Art pamor, klasa 10/12 përfshin :

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës planin vjetor të lëndës ose të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe planin e periudhës së parë (shtator- dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të fushës/ lëndës.

7.2 Planifikimi vjetor i lëndës.

Mësuesi, përveç programit mësimor duhet edhe të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik, ku mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tri periudha. Periudhat e planifikuara përmes planifikimit vjetor janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar – mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Shpërndarja e përmbajtjes kryesore së lëndës sipas tri periudhave, bëhet në këtë kolonë ku vendosen përmbajtja kryesore e lëndës që do të zhvillohet në secilën periudhë dhe për secilën tematikë. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihet njohuri, projekte, përsëritje, ekspozita, biseda, etj., në varësi të specifikave të lëndës.

Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Lënda e artit pamor zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje të detyruar në klasën X, XI, ose XII, në 36 javë mësimore me nga 2 orë në javë, pra gjithsej 72 orë. Programi i lëndës së artit pamor specifikon peshën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë, ku shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tabela 4: Planifikimi vjetor në lëndën e artit pamor, klasa 10-të

Klasa e 10-të/11-të ose 12-të	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe proceset	Historia, arti dhe shoqëria	Gjithsej orë
	15 orë	20 orë	37 orë	72 orë

Shënim:

Planifikimi vjetor kryhet duke u bazuar në orët e sugjeruara të kohës së përcaktuar në programin e miratuar nga Ministria. Mësuesit kanë të drejtë dhe liri të planifikojnë duke lëvizur deri në 10% nga orët e planifikuara orët e sugjeruara.

Realizimi i tri llojeve të planifikimit kërkon realizimin gjatë procesit të mësimdhënies edhe të disa rubrikave që përmban program mësimor. Ato janë:

- Ndërtimin e *kompetencave kyçe*.
- Ndërtimin e *kompetencave lëndore*.
- Përfshirjen dhe zbatimin e *temave ndërkurrikulare*.
- Përfshirjen dhe zbatimin e *fushave/lëndëve* të tjera.

Tabela 5: Planifikimi vjetor, në art pamor, klasa 10-të.

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave		
	Shtator – Dhjetor ----- orë	Janar – Mars ----- orë	Prill - Qershor ----- orë
1. Gjuha dhe Komunikimi artistik (15 orë)	Estetika Vija Forma dy dhe tre dimensionale: Ngjyrat Tekstura Kompozimi Hapësira Proporcionet		

2. Teknikat dhe proceset (20 orë)	Vizatimi Piktura Stampimi Fotografia	Dizajni dhe prezantimi Skulptura Konstruksioni	
3. Historia arti dhe shoqëria (37 orë)		Histori arti:	Histori arti: Periudha të historisë së artit Eksperienca artistike: Ekspozita dhe evente kulturore: Media:

7.3. Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ai është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planifikimin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës. Në planet sipas periudhave, planifikohen të gjitha orët.

Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes:

a) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së Artit pamor”.

b) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxëni nga programi mësimor sipas tematikave të përmbajtjes së lëndës së Artit pamor.

c) Numri rendor

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës së Artit pamor.

d) Tematika

Në këtë rubrikë shënohen tematikat mbi të cilat është ndërtuar teksti i lëndës Art pamor.

e) Tema mësimore

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Kjo rubrikë përmban:

Orë të detyruara për t'u planifikuar

- temat mësimore brenda të cilave do të realizohen rezultatet e të nxënit. Mësuesi orientohet sipas tekstit mësimor;
- orët e projektit kurrikular që do të zhvillojë mësuesi për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e artit pamor si dhe për zhvillimin e kompetencave të lëndës e kompetencave kyç. Mësuesi në varësi të kushteve specifike mund të planifikojë në lëndën e artit pamor të paktën 3 orë projekt kurrikular (për të gjithë vitin akademik);
- orë për përpunim njohurish etj., për të konsoliduar dhe zbatuar njohuritë dhe aftësitë e fituara në lëndën e muzikës;
- orët e **detyrave përmbledhëse** për të matur njohuritë dhe aftësitë e fituara nga nxënësit në periudhën përkatëse. Mësuesi planifikon 3 detyra përmbledhëse, nga një për çdo periudhë. Detyrat përmbledhëse planifikohen kur mësuesi e shikon të arsyeshme kohën e zhvillimit e tij, d.m.th jo detyrimisht në fund të periudhës, por edhe disa javë përpara se të mbarojë periudha.

f) Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi **nuk** zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale si pjesë e metodologjisë dhe organizimit të klasës.

g) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., kllaster, Diagrama e Venit, Kubimi, Tryeza e diskutimit, harta e konceptit, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

h) Vlerësimi

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim

mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; prezantim ose punë me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë nuk detajohet shumë sepse është e detajuar në planifikimin ditor.

i) Burimet

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të nxënësit si p.sh., teksti i nxënësit, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), materiale të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planifikimin ditor.

Tabela 6: Planifikimi i orëve mësimore për një periudhë, klasa 10.

Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Nxënësi:

- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike të krijimit, realizimit dhe analizimit të veprave të artit;
- -----
- -----

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- -----
- zgjidh probleme të ndryshme që lidhen me artin pamor, në jetën e përditshme apo në klasë/shkollë;
- -----
- -----

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi:

- vendos njohuritë pamore në funksion të realizimit të një argumenti, krijimi apo projekti artistik;
- -----
- -----

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

-
-
- inicion aktivitete ndërgjegjëse ndaj ruajtjes së mjedisit vizualisht pastër.

Kompetenca personale**Nxënësi:**

- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë veprimtarive artistike;
-

Kompetenca qytetare**Nxënësi:**

- promovon me qytetari, vlerat të ndryshme kulturore dhe artistike të vendit apo të krahinës;
-

Kompetenca digjitale**Nxënësi:**

- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet lidhur aspekte të ndryshme kulturore/artistike;
-

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës: *Krijimi artistik*****Nxënësi:**

-
- diskuton mbi artin duke u nisur nga disa qëndrime estetike;
- krijon punime arti dy dhe tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të larmishëm të gjuhës pamore;
-
-

Realizimi i punimit**Nxënësi:**

- demonstroi nivel të lartë në përdorimin e teknikave të larmishme artistike gjatë krijimit;
-
-

Vlerësimi artistik

Nxënësi:

- vlerëson veprën e artit në kontekstin kulturor dhe atë historik;
- -----
- -----

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
1	Teknika dhe procese artistike	Grafika	Kopertinat e librave Nxënësit nxiten të diskutojnë rreth kopertinave të librave që u kanë pëlqyer më shumë dhe pse. Ata zbulojnë edhe elementet përbërës të kopertinës së një libri apo reviste.	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; hetimi zbulimi; mendimin kritik dhe krijues;	Demonstrimi i rezultateve të arritura të njohurive, aftësive, qëndrimeve të krijuara përgjatë orës mësimore.	Teksti i artit pamor ; Ilustrime të veprave grafike dhe kopertinave
2		----- -----	----- -----			
3		----- -----	----- -----			
		-----	-----			

4						
5		-----	-----			
6		-----	-----			
7		-----	-----			
8		-----	-----			
9		-----	-----			
10		Projekt (Punë në grup)	-----			
11		-----	-----			
12	Historia, arti dhe shoqëria	-----	-----			
13		Arti prehistorik	Prehistoria Nxënësit diskutojnë mbi periudhën e prehistorisë duke u bazuar në njohuritë e tyre në lëndën e historisë.			
		-----	-----			

14						
15		-----	-----			
16		-----	-----			
17		Arti grek	Qytetërimi grek Nxënësit inkurajohen të diskutojnë mbi artin grek dhe shtrirjen e tij. Ata diskutojnë mbi periudhat e artit grek dhe mbi njohuritë që ata kanë marrë mbi këtë qytetërim antik në histori.			
18		-----	-----			
19		-----	-----			
20		-----	-----			
21		Detyrë përmbledhëse	Ekspozitë			

22		Diskutimi dhe vlerësimi i punimeve të ekspozitës	-----			
23		-----	-----			
24		-----	-----			

7.4 Planifikimi ditor

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore. Në ndryshim nga planifikimi tradicional, në planifikimin e kurrikulës me kompetenca kemi këto ndryshime:

Planifikimi (tradicional) i orës së mësimit	Planifikimi bazuar në kompetenca i orës së mësimit
- Në planifikim përcaktohet çfarë bën mësuesi për të realizuar mësimin.	- Në planifikim përcaktohet çfarë bëjnë nxënësit ndërsa realizohet mësimi (situatat, veprimtaritë, detyrat).
- Mësimi përqendrohet pothuajse te përmbajtja.	- Mësimi përqendrohet mbi proceset dhe mbi veprimtaritë.
- Mësimi pritet të ketë të njëjtin organizim të orës së mësimit gjithmonë.	- Mësimi nuk ka të njëjtën metodologji gjithmonë. Organizimi varet nga rezultatet që duam të arrijmë.
- Roli i mësuesit është kryesisht ligjërues (shpjegon).	- Roli i mësuesit është organizator duke mbizotëruar dhe duke e vënë theksin te bashkëveprimi i nxënësve.

Shembuj të foljeve për rezultatet e të nxënit sipas kompetencave muzikore

Folje të përgjithshme sipas taksonomisë së Blumit	Folje më specifike për ndërtimin e kompetencave
<i>kujton</i>	këndon, pranon; sjell ndërmend; identifikon; emërton, luan etj.
<i>kupton</i>	interpretton; luan, ilustron; klasifikon; përmbledh; konkludon; shpjegon; qartëson; perifrazon; paraqet; ilustron; parashikon; regjistron; lidh etj.
<i>zbaton</i>	ekzekuton; realizon, identifikon; përgjithëson; kryen; përdor; luan përmendësh, etj
<i>analizon</i>	këndon, organizon; i vë përballë; dallon; përqendron; përzgjedh; integron, skicon; analizon, liston duke analizuar, etj.
<i>vlerëson</i>	zbulon; krahason; teston; gjykon; kontrollon; kritikon;
<i>krijon</i>	gjeneron; planifikon; prodhon; hamendëson; ndërton; sintetizon.

Tabela 7: Model i orës së mësimi, lënda Arti Pamor

Planifikime ditore, nga Arsimi i Mesëm i Lartë, klasa 10 -të.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 5	Klasa: 10/12-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik Tema mësimore: Ngjyrat		Situata e të nxënit: Ngjyrat në veprat e artit Nxënësit/et diskutojnë mbi njohuritë dhe eksperiencat e tyre mbi elementin e ngjyrës. Ngjyrat e para dhe të dyta, rrethi i ngjyrave, ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta, kontrasti i ngjyrave dhe mënyra sesi shfaqen ato në veprat e artit, janë argumentet e diskutimit të tyre.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe: - Kontrasti i ngjyrave	

- vëzhgon me vetëdije përdorimin e ngjyrës në vepra të ndryshme të artit; - reflekton mbi mënyrat e ndryshme të përdorimit të ngjyrës në vepra të ndryshme të artit; - zbulon mundësitë shprehëse të ngjyrës të përdorur nga artistët gjatë zhvillimit të historisë së artit; - përdor në mënyrë shprehëse ngjyrën, duke u mbështetur në vepra të ndryshme të historisë së artit për të komunikuar ide personale.	- Ngjyra mbizotëruese, - Ngjyra në skulpturë, arkitekturë dhe dizajn
Burimet/mjetet/materialet: - teksti i nxënësit; - Ilustrime të veprave të artit; - mjete pune	Lidhja me lëndët e tjera: - Gjuhët dhe komunikimi, - Letërsia, - Historia, - Fizika.
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve- (5 minuta) Teknika: Kllasteri Nxënësit diskutojnë mbi njohuritë dhe eksperiencat e tyre mbi elementin e ngjyrës. Ngjyrat e para dhe të dyta, rrethi i ngjyrave, ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta, kontrasti i ngjyrave dhe mënyra sesi shfaqen ato në veprat e artit, janë argumentet e diskutimit të tyre.	
Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja-(30 minuta) teknika: Kujtesa pamore, hulumtimi, eksperimenti. Nëpërmjet imazheve të veprave të ndryshme të artit nxënësit/et identifikojnë mundësitë shprehëse të ngjyrës. Ata identifikojnë midis ngjyrave të pastra, kontrastin e toneve bardhezi të ngjyrave, kontrastin e ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta, kontrastin e ngjyrave plotësuese, mbizotërimin e një ngjyre, në vepra të ndryshme arti. Nxënësit zbulojnë dhe reflektojnë mbi përdorimin e ngjyrës në skulpturë dhe arkitekturë nëpërmjet shembujve të ndryshëm. Veprimtari	

Duke u mbështetur në efektin e dritës në piktura të ndryshme, nxënësit nxiten të realizojnë një imazh të njëjtë dy deri në tri herë. Ata përdorin raporte të ndryshme ngjyrash për secilin imazh duke zgjedhur teknikën sipas dëshirës.

Hapi i tretë: reflektimi (10 minuta)teknika: diskutim

Nxënësit diskutojnë mbi efektet që ka krijuar raporti i ngjyrave të përdorura në imazhet e realizuara prej tyre

Vlerësimi i nxënësit

Ky vlerësim do të fokusohet:

N2 - në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;

N3 - në identifikimin e mundësive shprehëse të ngjyrës në vepra të ndryshme arti;

N4 - në mënyrën e realizimit të detyrës;

N4 - në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Krijim ose kërkim individual (detyrë shtëpie)mbi temën

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 5	Klasa: 10/12-të
Tematika: Historia, arti dhe shoqëria. Tema mësimore: Arti prehistorik		Situata e të nxënit: Prehistoria Nxënësit diskutojnë mbi periudhën e prehistorisë duke u bazuar në njohuritë e tyre në lëndën e historisë. Ata diskutojnë edhe për artin prehistorik si artefakte të rëndësishme që hedhin dritë mbi këtë periudhë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: - vëzhgon artefakte nga periudha prehistorike; - përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson artefakte dhe gjetje arkeologjike të periudhave të prehistorisë lidhur ngushtë me karakteristikat e zhvillimit të tyre historik; - argumenton dhe komunikon mendimin e tij mbi veprën;		Fjalët kyçe: - Arti prehistorik, - Paleoliti, - Mezoliti, - Neoliti, - Artefakte, - Megalitet, - Pikturat e shpellave,	

- analizon dhe paraqet informacionin e mbledhur në mënyrë individuale rreth shenjave në prehistori.	- Palafite.
Burimet/mjetet/materialet: - teksti i nxënësit; - ilustrime të artefakteve nga prehistoria.	Lidhja me lëndët e tjera. - Gjuha, - Historia, - Gjeografia, - Teknologjia.
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve- (5 minuta)<i>Teknika:</i> brainstorming Nëpërmjet teknikës brainstorming mësuesi stimulon mendimin e lirë mbi temën qendrore “Prehistorinë”. Nxënësit diskutojnë mbi periudhën e prehistorisë duke u bazuar në njohuritë e tyre në lëndën e historisë. Ata diskutojnë edhe për artin prehistorik si artefakte të rëndësishme që hedhin dritë mbi këtë periudhë.	
Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja-(30 minuta)<i>Teknika: Kllasteri; Kujtesa pamore; Diskutimi</i> Mësuesi/ja shpjegon se periudhat kryesore të prehistorisë janë: <i>Paleoliti (Epoka e Gurit të Lartë), Mezoliti (Epoka e Gurit të Mesëm), dhe Neoliti (Epoka e Gurit të Vonë).</i> Nëpërmjet teknikës së kllasterit renditen karakteristikat e secilës periudhë duke u shpjeguar e radhë. Në fillim mësimi fokusohet në shtrirjen kohore, në artefaktet e periudhave me karakteristikat e tyre dhe në banesat e para primitive. Mësimi shoqërohet me imazhe ilustruese dhe me diskutime. Hapi i tretë: reflektimi (10 minuta)<i>Teknika: Diagrami i venit</i> Nëpërmjet diagramit të venit, nxënësit bëjnë një përmbledhje të njohurive të mara. Ata ndajnë karakteristikat e veçanta të secilës periudhë dhe gjejnë edhe ato të përbashkëta. Ata diskutojnë mbi argumentet e trajtuara gjatë mëimit.	
Vlerësimi i nxënësit Ky vlerësim do të fokusohet: N2 - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re; N3 - në pjesëmarrjen e tyre aktive në diskutime gjatë procesit mësimor;	

N4 - në reflektimin mbi karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta të periudhave të zhvillimit të artit në prehistori

Krijim ose kërkim individual (detyrë shtëpie) mbi temën

Shembull: Plani ditor

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 5	Klasa: 10/12
Tematika: Teknika dhe procese artistike Tema mësimore: Skenografia; Skena në miniaturë		Situata e të nxënit: Skenografia teatrale dhe puna e skenografit Nxënësit/et diskutojnë mbi shfaqje të ndryshme teatrale apo shfaqje të ndryshme dhe skenën e tyre. Ata identifikojnë edhe komponentët e skenës.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: - Zbulon karakteristikat e projektimit të skenës dhe punën e skenografit; - përdor mjetet dhe materialet e duhura në realizimin e moketit të një skene; - organizon informacionin, përcakton fazat dhe kohën që i duhet për të realizuar idenë dhe moketin e skenës; shpreh idetë në mënyrë origjinale nëpërmjet përdorimit me kompetencë të teknikave të duhura artistike.		Fjalët kyçe: - Skenografi, - kostumografi, - skena, - moket, - shfaqje teatrale, kinematografike, televizive.	
Burimet/mjetet/materialet: - Teksti i nxënësit; - imazhe të ndryshme që ilustrojnë njohuritë; - mjete pune.		Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare. Lidhje me fushat kurrikulare: - Gjuhët dhe komunikimi: letërsia; - teknologjia. Lidhja me temat ndërkurrikulare:	

	- Njohja e kulturave.
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve	
Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Nxënësit/et diskutojnë mbi shfaqje të ndryshme teatrale apo shfaqje të ndryshme dhe skenën e tyre. Ata identifikojnë edhe komponentët e skenës si ndriçimin, kostumet dhe materialet e ndryshme që përdoren. Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja shpjegon se në teatër, ndihet një raport shumë i ngushtë midis fushave të ndryshme të shprehjes artistike. Teatri përbëhet nga dy hapësira. Në hapësirën e skenës ndërtohet edhe skenografia. Shpesh ideja ndërtohet në një model tredimensional në shkallë të zvogëluar, për të kuptuar më mirë problemet teknike dhe estetike. Mësuesi shpjegon maketin, procesin e realizimit të tij dhe materialet që përdoren. Nxënësit nxiten të bëjnë kërkime rreth temës. Në fillim hedhin idetë në skica. Nxënësit ndajnë punën për çdo anëtar të grupit. Ata ndërtojnë skenën e tyre në miniaturë. Hapi i tretë: Reflektimi Nxënësit diskutojnë mbi temën që kanë zgjedhur, idetë, skicat dhe për mënyrën e realizimit të skenës dhe për karakteristikat e saj në lidhje me shfaqjen.	
Vlerësimi i nxënësit Ky vlerësim do të fokusohet: ▪ në diskutimet që ata/ bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; ▪ në vlerësimin e punës së secilit nxënës; ▪ në mënyrën e realizimit të detyrës; ▪ në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.	

VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN ART PAMOR

Qëllimi kryesor i vlerësimit është **përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënësve** nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënësve. Vlerësimi është procesi gjatë të cilit **mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën** e arritjes së rezultateve të të nxënësve, duke u bazuar në nivelet e arritjes. Vlerësimi përdoret:

- ☞ për të gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve për të nxënë;
- ☞ për të motivuar dhe për të nxitur nxënësit për të nxënë;

- ✎ për të gjykuar, reflektuar dhe përmirësuar procesin e mësimdhënie -nxënies;
- ✎ për të matur arritjet e nxënësve;
- ✎ për të raportuar arritjet;
- ✎ për t'u dhënë sugjerime nxënësve për përparimin e tyre;
- ✎ për t'u dhënë sugjerime prindërve mbi përparimin e fëmijëve të tyre.

Vlerësimi në art pamor mat arritjet e nxënësve për rezultatet e të nxënit të përshkruara në programin mësimor. Është një proces i vazhdueshëm i identifikimit, mbledhjes dhe interpretimit të informacionit në lidhje me arritjet e nxënësit dhe mund të integrohet në të nxënit normal të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- ✎ vlerësimi të vazhduar;
- ✎ vlerësimi me detyrë përmbledhëse;
- ✎ vlerësimin me projekt kurrikular.

8.1. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)

- Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësit në të gjitha aspektet e të nxënit, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.
- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe në gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe në debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.
- Mësuesi vlerëson nxënësin me notë në regjistër, vetëm pasi është siguruar që ky vlerësim është objektiv dhe shpreh shkallën e qëndrueshmërisë së performancës së nxënësit për një periudhë të caktuar kohe. Për këtë qëllim, mësuesi përdor fletoren e tij personale të regjistrimit të përgjigjeve të nxënësit, për të argumentuar në çdo kohë, objektivitetin e vlerësimi të tij me notë në regjistër.
- Fletorja personale e mësuesit nuk është objekt monitorimi.
- Mësuesi shënon në regjistër të paktën 2 (dy) vlerësime me notë për çdo periudhë.
- Mësuesi nxjerr notën e vlerësimi të vazhduar për çdo periudhë duke u bazuar në notat e nxënësit në regjistër dhe në shënimet që ka mbajtur në fletoren e tij personale. Mësuesi merr në konsideratë balancën ndërmjet njohurive, shkathtësive, qëndrimeve, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënit në programin lëndor.

- Mësuesi ka përgjegjësi për të informuar prindërit dhe nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e nxënësit për progres.

Shembull i fletores së mësuesit për vlerësimin e vazhduar për 1 (një) periudhë (shtator-dhjetor), klasa 10-të.

Nr	Tema Muaj	1	2	3	4	5	6	TEMAT	VLERËSIMI
Data	Emër	1	2	3	4	5	6	1	2
1								Forma 2 dhe 3 dimensionale	
2								Hapësira	
3								Psikologjia e ngjyrës	
4								Kompozimi	
5								Baraspesha	
6								Ekspozita	
7								etj...	

Legjendë: ++ (sh. mirë); + (mirë); +- dhe ✓ (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; - - (sh. dobët). N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. KSh – Kuic i shkurtër.

(++) Shpreh nivel arritje N 4 (shumë mirë) aktivizim i shumë i rregullt, bashkëpunim i vazhdueshëm me të tjerët; krijim artistik vetëm ose në grup; përdorimi me kompetencë i teknikave artistike, analizë dhe vlerësim i veprave të artit dhe periudhave artistike).

(+) Shpreh nivel arritje N 3(mirë) aktivizim i vazhdueshëm, bashkëpunim me të tjerët; krijim artistik me ndihmë; përdorimi i teknikave artistike, përshkrimi i veprave të artit dhe periudhave artistike).

(+ -) Shpreh nivel arritje N 2(mesatar) mosbashkëpunim në krijim; mospërdorimi i duhur i teknikave artistike; mos pjesëmarrje në përshkrimin dhe vlerësimin e veprave të artit dhe periudhave artistike).

(-) Shpreh nivel arritje N 1(dobët) mosbashkëpunim në të gjitha aktivitetet e zhvilluara në klasë.

8.2. Vlerësimi i të nxënit (Detyra përmbledhëse)

Vlerësimi i të nxënit ndryshe quhet vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Ky është një vlerësim formal dhe kryhet edhe për efekt raportimi.

Si dhe kur realizohet detyra përmbledhëse

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet **detyra përmbledhëse**, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.
- Mësuesi ka lirinë të përcaktojë vetë detyrën përmbledhëse sipas specifikave të lëndës.
- Detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi kur përmbillet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është **i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë**.
- Detyra përmbledhëse është 45 minuta.
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
- Detyra përmbledhëse **jo domosdoshmërisht** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë.
- Në momentin kur mësuesi **vlerëson detyrat përmbledhëse, i vendos** notat në regjistër.
- Mësuesi duhet **të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor** detyrat përmbledhëse.

Vlerësimi me detyrë përmbledhëse është një vlerësim që për lëndën e artit pamor duhet të zhvillohet më shumë nëpërmjet një aktiviteti gjithëpërfshirës p.sh.: ekspozitë me tematikë të caktuar, detyrë në grupe, konkurs, etj., ku secili ka një rol të caktuar në detyrën e vet. Detyra përmbledhëse, ka për qëllim të mat nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënit. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të vlerësohen nëpërmjet një larmie mënyrash vlerësimi:

- Konkurs me njohuritë përmbledhëse të periudhës p.sh.: shtator - dhjetor.
- Krijime individuale ose punë në grup që përfshijnë njohuritë e periudhës.
- Ekspozitë/ që përfshin punimet e realizuara gjatë një periudhe, ose ekspozitë me tematikë të caktuar (me qëllim përdorimin e njohurive të marra në punimet artistike).

Shënim: Në lëndën e artit pamor ky vlerësim nuk bëhet me test por me detyrë përmbledhëse. Detyra përmbledhëse synon të masë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet në fund të periudhës për ndërtimin e kompetencave pamore.

MËSUESI është ai që vendos mënyrën e matjes së kompetencave pamore përmes detyrës përmbledhëse.

Analiza e rezultateve të detyrës përmbledhëse dhe puna e mësuesit për përmirësimin e rezultateve të nxënësve.

Analiza e rezultateve të detyrës përmbledhëse është një detyrë e vazhdueshme e mësuesit dhe mjaft e rëndësishme në vetëvlerësimin e performancës së tij në periudha të ndryshme, në lidhje me rezultatet e nxënësve. Kjo lloj analize bën të mundur që mësuesi të kuptojë shkaqet e rezultatit të nxënësve (në këtë rast marrim si shembull, rezultate të pakënaqshme) në detyrën përmbledhëse. Shkaqet mund të jenë të ndryshme dhe mund të kenë lidhje; *si me njohuritë dhe aftësitë e tyre të mëparshme; me humbjen e interesit të nxënësve ndaj artit pamor (kjo si rezultat i interesave ndaj artit që lidhen me moshën ose me mungesën e motivimit); përzgjedhjen e veprimtarive artistike jo në përshtatje me interesat e moshës apo aftësitë personale të secilit; apo përdorimi jo në mënyrë efektive i metodave të mësimdhënies; etj..*

Një analizë e tillë do ta çojë mësuesin drejt reflektimit me kujdes ndaj çdo shkakut të mundshëm, si në mënyrë personale ndaj çdo nxënësi, ashtu edhe në rang klase. Ky reflektim do të sillte edhe zgjidhjet e duhura brenda çdo problemi specifik. *Për shembull*, nëse rezultatet e pakënaqshme kanë lidhje me humbjen e interesit të nxënësve ndaj artit pamor, në këtë rast puna dhe orientimi i duhur nga ana e mësuesit të artit është mjaft i rëndësishëm. Një nga detyrat e një mësuesi është që të gjejë mënyrën për t'i udhëhequr këta nxënës drejt vetë-pranimit. Në rastet ekstreme, ai mund të tregohet i zgjuar që t'i përqendrohet më tepër në veprimtaritë e krafeve se sa te ato të vizatimit dhe të pikturës. Në këtë periudhë, njohuritë mbi elementet dhe teknikat marrin përparësi dhe përzgjedhja e metodave të duhura mësimore dhe e veprimtarive artistike në përshtatje me aftësitë dhe me interesat e nxënësve do të sillnin rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe arritjen e rezultateve të të nxënësit.

8.2.1 Shembull – Detyrë përmbledhëse, konkurs midis skuadrave

Shembull i detyrës përmbledhëse: *Konkurs me dy skuadra*

Në përfundim të periudhës në artin pamor, një mënyrë e vlerësimit është edhe detyra përmbledhëse. Detyra përmbledhëse mund të jetë një *konkurs* i zhvilluar në klasë mbi njohuritë e marra gjatë tremujorit. Nxënësit e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. Pyetjet ndërtohen rreth njohurive të marra gjatë tremujorit. Për të ndërtuar një pyetësor nxënësit orientohen nga mësuesi dhe libri. Mësuesi orienton nxënësit në hartimin e pyetjeve, në numrin dhe në pikëzimin e tyre.

Nxënësit kanë bërë edhe një punë paraprake të mbledhjes së imazheve që do të jenë pjesë e pyetësorit.

Shembuj të pyetjeve nga tematika: Historia, arti dhe shoqëria.

1. Cili ishte subjekti më i përdorur në pikturën impresioniste?

1 pikë

- A) Kompozim me figura
- B) Portreti
- C) Peizazhi
- D) Natyra e qetë

2. Realizimi i vetratave shumëngjyrëshe për katedralet ishte karakteristikë e:

1 pikë

- A) Periudhës romanike
- B) Periudhës bizantine
- C) Periudhës gotike
- D) Periudhës së rilindjes

3. Metoda e realizmit socialist lindi në:

1 pikë

- A) Shqipëri
- B) Bashkimin Sovjetik
- C) Vendet e kampit socialist
- D) Në të gjitha vendet njëherësh

4. Artisti “simbol i Rilindjes italiane” konsiderohej:

1 pikë

- A) Bruneleski (Fillipo Brunelleschi)
- B) Donatelo (Donatello)
- C) Botiçeli (Sandro Botocelli)
- D) Leonardo da Vinçi (da Vinci)

- 5. Pop arti lindi në:** **1 pikë**
- A) SHBA dhe Angli
 - B) Angli dhe Francë
 - C) SHBA dhe Francë
 - D) SHBA dhe Itali
- 6. Postimpresionistët ishin artistë të cilët:** **1 pikë**
- A) U rebeluan kundër kufizimeve të impresionizmit
 - B) Krijuan stilin e artit abstrakt
 - C) Ruajtën traditat artistike të impresionistëve
 - D) Patën pak ndikim në artin e shek. XX
- 7. Pjesë e grupit të njohur si “Seçesioni Vjenez” ishin artistët:** **1 pikë**
- A) Gustav Klimt dhe Egon Schiele (Schiele)
 - B) Pol Kle (Poul Klee) dhe Kandinski (Vasili Kandinskij)
 - C) Franc Marc (Mark) dhe Andre Derain (Dera)
 - D) Vlamink (Maurice de Vlaminck) dhe Zhorzh Rua (Georges Rouault)
- 8. Artisti që e çoi pikturën drejt abstraksionizmit total ishte:** **1 pikë**
- A) Franc Mark (Franz Marc)
 - B) Kandinski (Vassily Kandinsky)
 - C) Pol Kle (Paul Klee)
 - D) Emil Nolde (Emile Nolde)
- 9. Me çfarë materiali realizohej mozaiku bizantin?** **1 pikë**
- _____
- 10. Rendit dy nga piktorët italianë më të njohur të periudhës Gotike.** **2 pikë**
- 11. Në cilën periudhë të artit perëndimor, ndikoi arti japonez?** **1 pikë**
- _____

12. Çfarë *synonte* arti abstrakt në lidhje me paraqitjen e realitetit?

2 pikë

13. Renditni tri përfaqësuesit më të rëndësishëm në pikturë, skulpturë dhe arkitekturë që i përkasin artit barok në Itali.

3 pikë

a. _____

b. _____

c. _____

14. Ku lindi futurizmi, cilat ishin subjektet e tyre të preferuara?

2 pikë

15. Përmend disa nga emrat e artistëve shqiptarë që sollën metodën e realizmit nga vendet e Lindjes?

3 pikë

16. Çfarë kanë të përbashkët për sa i përket subjektit të frymëzimit, romantizmi dhe neoklasicismi?

2 pikë

17. Cilat ishin dy qytetet ku e zhvilloi veprimtarinë e tij Onufri?

2 pikë

1. _____

2. _____

3. _____

18. Ku lindi realizmi dhe kujt iu kundërvu?

2 pikë

▪ _____

19. Cili është artisti që themeloi pikturën realiste shqiptare rreth vitit 1880 në Shkodër?

Përmend dy nga punët e tij më të njohura.

2 pikë

Skema e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
pikët	12	13-15	16-18	19-21	22-24	25-27	28-30

Shembull I: Plani ditor i detyrës përmbledhëse: *Konkurs me dy skuadra* (mbi njohuritë e marra gjatë tremujorit).

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 5-6	Klasa: X-XII
Tematika: Historia, arti dhe shoqëria. Tema mësimore: Konkurs me dy skuadra		Situata e të nxënësve: Verifikoj njohuritë mbi historinë e artit Nxënësit e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. Nxënësit kanë bërë edhe një punë paraprake të mbledhjes së imazheve që do të jenë pjesë e pyetësorit.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore <i>Nxënësit:</i> - Zhvillon aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese; - përdor fjalorin e përshtatshëm artistik mbi historinë e artit për të formuluar pyetjet; - formulon dhe u përgjigjet saktë pyetjeve në konkurs; - shpreh mendimin e tij/saj për rezultatet e arritura në konkurs nga skuadra.		Fjalët kyçe: - Fjalori artistik; - pyetësor; - konkurs.	
Burimet/mjetet/materialet: - Teksti i nxënësit;		Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.	

- fotografi dhe ilustrime nga vepra të artit.	<i>Lidhje me fushat kurrikulare:</i> - Gjuhët dhe komunikimi: letërsia; - teknologjia; - shkencat shoqërore. <i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i> - Njohja e kulturave.
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve	
<i>Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> - Nxënësit e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. - Nxënësit kanë bërë edhe një punë paraprake të mbledhjes së imazheve që do të jenë pjesë e pyetësorit.	
<i>Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja</i> - Mësuesi i orienton nxënësit të vendosin rregullat e konkurrimit dhe pikët e pyetjeve. - Nëpërmjet një shorti ata caktojnë se cila nga skuadrat do të fillojë pyetësorin e para. - Gjatë kohës së konkurrimit një nxënës/e mbledh pikët dhe kur skuadra që nuk i përgjigjet pyetjes ose i përgjigjet asaj pjesërisht, skuadra tjetër jep përgjigjen dhe argumenton pikët. - Në këtë mënyrë vazhdon konkurrimi deri në përfundim të pyetësorit. - Argumentimi i përgjigjeve dhe i pikëve është shumë i rëndësishëm gjatë konkurrimit. <i>Hapi i tretë: Reflektimi</i> - Në përfundim të konkurrimit përzgjidhet skuadra fituese sipas numrit të pikëve të mbledhura. - Nxënësit diskutojnë për mënyrën e formulimit të pyetjeve. - Çdo skuadër nxjerr konkluzionet e punës në grup dhe tregon nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin. Nëse jo duhet të tregojnë se cilat ishin arsyet.	
<i>Vlerësimi i nxënësit</i> Ky vlerësim do të fokusohet: ▪ Në diskutimet dhe bashkëpunimin për të realizuar pyetësorin; ▪ në cilësinë e realizimit të pyetësorit; ▪ në cilësinë e përgjigjeve të pyetjeve; ▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë zhvillimit të konkursit.	

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e formulimit të pyetjeve për skuadrën tjetër dhe saktësisë së përgjigjeve të pyetjeve të bëra nga skuadra tjetër. Në këtë detyrë përmbledhëse është shumë e rëndësishme mënyra sesi funksionon puna në grup dhe vlerësimi që skuadrat i bëjnë njëra tjetrës.

8.2.2. Shembull - Detyrë përmbledhëse, Ekspozitë

Detyra përmbledhëse mund të jetë një *ekspozitë* në klasë me detyrat e realizuara gjatë tremujorit. Detyra e realizimit të një ekspozite mund të jetë edhe një projekt, në rastin kur nxënësit ekspozojnë detyra me një tematikë të caktuar më parë por edhe me punime të realizuara në shtëpi për përfundimin e njohurive të marra. Në këtë rast kjo ekspozitë shërben si një detyrë përmbledhëse mbi njohuritë e marra në tematikën “Historia, arti dhe shoqëria” e cila i përket edhe periudhës së tretë. Nxënësit vlerësohen:

- Për diskutimet mbi përzgjedhjen e punëve dhe mënyrën e ekspozimit,
- për mënyrën e prezantimit të punëve dhe saktësisë së prezantimit të karakteristikave të periudhës,
- për bashkëpunimin në grup, pjesëmarrjen e tyre aktive dhe vlerësimi që grupet i bëjnë njëra tjetrës.

Shembull I: Plani ditor i detyrës përmbledhëse: Ekspozitë

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 5-6	Klasa: X-XII
Tematika: Historia, arti dhe shoqëria. Tema mësimore: Ekspozitë.		Situata e të nxënit: Diskutime mbi mënyrën e përgatitjes së ekspozitës Nxënësit diskutojnë së bashku mbi mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura. Mësuesi/ja i orienton nxënësit në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore <i>Nxënësi:</i> - Zhvillon aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese; - diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës;		Fjalët kyçe: - Përzgjedhja e punimeve; - ekspozita; - organizimi i ekspozitës.	

- përzgjedh punimet për ekspozim sipas periudhave artistike; - shpreh mendimin e tij/saj për realizimin e ekspozitës.	
Burimet/mjetet/materialiet: - Teksti i nxënësit; - punimet e nxënësve; - mjete të nevojshme për realizimin e ekspozitës.	Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare. Lidhje me fushat kurrikulare: - Gjuhët dhe komunikimi: letërsia; - teknologjia; - shkencat shoqërore. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - Njohja e kulturave.
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve	
Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - Nxënësit diskutojnë së bashku mbi mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura. - Mësuesi i orienton nxënësit në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë.	
Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit ndahen në skuadra, ku çdo skuadër zgjedh periudhat artistike që do të prezantojë. Pasi kanë përcaktuar hapësirat për ekspozim dhe kanë përzgjedhur punimet e një periudhe artistike, i vendosin ato në tabak kartoni. Në tabakët ku ndodhen punimet e realizuara duke u mbështetur në një periudhë të caktuar, nxënësit vendosin karakteristikat e periudhës dhe autorët kryesorë. Më pas i vendosin në muret e klasës. Çdo skuadër prezanton punimet e realizuara prej tyre duke u frymëzuar nga periudha përkatëse, karakteristikat dhe përfaqësuesit kryesor. Hapi i tretë: Reflektimi Ata diskutojnë mbi punimet e tyre dhe mënyrën e realizimit duke nxjerrë në pah edhe karakteristikat e periudhës. Nxënësit nxjerrin përfundimet e punës në grup duke u shprehur nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin dhe nëse ekspozita ia arriti qëllimit.	

Vlerësimi i nxënësit

Ky vlerësim do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata/ato bëjnë mbi përzgjedhjen e punëve dhe mënyrën e ekspozimit;
- në mënyrën e prezantimit të punimeve dhe periudhës artistike;
- në saktësinë e prezantimit të karakteristikave të periudhave artistike;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë diskutimeve.

8.3. Projekti

Projekti kurrikular në lëndën e artit pamor është rubrikë e detyruar dhe është pjesë e vlerësimit të nxënësit.

Gjatë vlerësimit me projekt kurrikular:

- Mësuesi planifikon dhe organizon një projekt të shtrirë gjatë gjithë vitit shkollor.
- Projekti kurrikular mund të jetë lëndor ose ndërlëndor, mund t'i përkasë një fushe të nxëni ose të shtrihet në më shumë se një fushë të nxëni.
- Drejtoria e shkollës menaxhon kohën e prezantimit dhe të vlerësimit të projektit kurrikular që të shmanget mbingarkesa e nxënësve në fund të vitit shkollor.
- Nota e projektit kurrikular shënohet në regjistër në kolonën përkatëse.
- Projektet e nxënësve ruhen deri në fund të vitit shkollor.

Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj. Projekti nxit të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.

Projekti kurrikular duhet të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij. Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënit që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e

vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme. Realizimi i një projekti kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: vrojtimi, studimi i rastit, intervista, puna në grup, puna individuale, përpunim informacioni statistikor etj.

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij, mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditor çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

- *Tema e projektit* (Përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit)
- *Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore* (Nëse projekti është ndërhlëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë).
- *Klasa/t pjesëmarrëse:* (përcaktohet klasa ose në rast se ka disa klasa).
- *Rezultatet e të nxënësve* – (Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.)
- *Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:* (përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti).
- *Partnerët* (nëse ka, p.sh., nëse projekti mbi **Artin figurativ shqiptar** (periudha e ndërtimit të socializmit) në lëndën e artit pamor ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë lidhur me zhvillimin

- edhe në fusha të tjera të arteve, por edhe më gjerë, duke pasur si mbështetje edhe mësuesit e këtyre lëndëve dhe orientimin e tyre për gjetjen e informacionit; arkivat; interneti; galeria, etj..
- *Veprimtaritë kryesore:* (përcaktohen veprimtaritë që do të realizohen gjatë projektit).
 - *Burimet kryesore të informacionit* (Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit. Në lëndën e artit pamor një burim i çmuar informacioni, përveç internetit, librave dhe teksteve të ndryshme, revistat, etj. janë edhe muzetë apo studiot dhe bisedat me artistët).
 - *Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:* (këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. P.sh., kur projekti planifikohet në 3 orë atëherë duhet vendosur tematika për të tre orët).
 - *Përshkrimi i produktit të projektit* (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).
 - *Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi* (Mësuesi përcakton kritere për vlerësimin e projektit të cilat ia komunikon nxënësit që në fillim të projektit. P.sh., kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënës.
 - Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësore për të nxënë bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënës e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobëta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme).

Shembull i vlerësimit të projektit kurrikular. Çdo mësues është i lirë të vendosë vetë kriteret e vlerësimit të projektit sipas tematikës që ka përzgjedhur për të realizuar me nxënësit.

Projekti është hulumtues/kërkimor - (shtrihet gjithë vitin)				
Projekti përmban gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	<i>Niveli 1 Dobët 0-10 pikë</i>	<i>Niveli 2 mjaftueshëm 11 - 21 pikë</i>	<i>Niveli 3 Mirë 22- 32 pikë</i>	<i>Niveli 4 Shumë mirë 33 -40 pikë</i>
(Faza e parë) 15 pikë	0-4 pikë Nxënësit: - rrallëherë: fokusohen te detyra e tyre.	5-8 pikë Nxënësit: - dalin jashtë temës dhe nuk	9-12 pikë Nxënësit: - janë të fokusuar te detyra e tyre	13-15 pikë Nxënësit: - janë të fokusuar te detyra e tyre. Vetëorientohen dhe

Demonstrimi i aftësive kërkimore	- Mbledhin informacione jo të përshtatshme. - Përdorin një burim për të gjetur informacionin.	fokusohen vetëm te - detyra e tyre. - Mbledhin informacion dhe përmbledhin ato. - Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	shumicën e kohës. - Mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde. - Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	vetëdrejtohen shumë mirë. - Mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe krijojnë komente intuitive për të zgjidhur probleme. - Përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
(Faza e dytë) 15 pikë Realizimi i kërkimit të gjetur	0 -4 pikë Nxënësit: -rrallëherë përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit. - informacioni i gjetur shpeshherë është jo i saktë.	5– 8 pikë Nxënësit: - ndonjëherë përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit, por jo në mënyrë të vazhdueshme. - Shtjellimi i kërkimit është me gabime.	9 – 12 pikë Nxënësit: - zakonisht përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit të përshtatshme dhe efektive. - Shtjellimi i kërkimit përmban pak gabime.	13 – 15 pikë Nxënësit: - përdorin gjatë gjithë projektit përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit të përshtatshme dhe efektive. - Shtjellimi i kërkimit është i saktë dhe i qartë.
(Faza e tretë) 10 pikë Prezantimi në mënyrë efektive i projektit	0-2 pikë - Prezantimi i materialit është i çorganizuar dhe rrëmujë - Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin.	3 -5 pikë - Prezantimi i materialit është i organizuar mirë punën e tyre - jo gjithmonë të krijojnë lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari.	6-8 pikë Prezantimi i materialit është organizuar mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijojnë lehtësi leximi dhe të kuptuari. Në përgjithësi prezantohen	9-10 pikë - Prezantimi i materialit është organizuar shumë mirë punën e tyre që të krijojnë lehtësi leximi dhe të kuptuari. - Rezultatet e projektit

	- Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.	- Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.	rezultatet e projektit.	prezantohen qartë.
--	---	--	-------------------------	--------------------

Shembull i vetëvlerësimit ose e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Edhe ky shembull është një model që shërben për të orientuar çdo mësues dhe nxënës rreth vlerësimit. Edhe në këtë rast çdo mësues është i lirë të vendosë kriteret sipas tematikave që përzgjedh të zhvillojë.

Projekt kurrikular kërkimor Gjithsej 40 pikë (nëse projekti shtrihet gjithë vitin)					
Kriteret e vlerësimit	Treguesi	ShM	M	Mj	D
(Faza e parë) 15 pikë Demonstrimi i aftësive kërkimore	- Demonstrim i aftësive kërkimore.				
	- Bashkëpunimi në grup.				
	- Grupi orientohet dhe drejtohet vetë.				
	- Përdorimi i shumëllojshmërisë së informacioneve				
	- Fokusimi te detyra e dhënë.				
(Faza e dytë) 15 pikë Realizimi i kërkimit të gjetur	- Përdorimi gjatë projektit i aftësive kërkimore të përshtatshme dhe efektive.				
	- Kërkimi i selektuar i veprave artistike.				
	- Përdorimi i informacionit të gjetur dhe veprave të artit për demonstrim.				
(Faza e tretë)	- Organizimi i materialit që të krijon lehtësi leximi dhe të kuptuari.				

10 pikë Prezantimi në mënyrë efektive i projektit	- Rezultatet e projektit prezantohen qartë.				
	- Kontribuon pozitivisht në progresin e grupit.				

Shembull projekti kurrikular me shtrirje gjithë vjetore, për lëndën e artit pamor për klasën e 10-të:

1. *Tema e projektit* “Arti i realizmit socialist në Shqipëri, përfaqësues dhe vepra”
2. *Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore*: Projekti do të zgjasë gjatë tri periudhave të realizuara në 3 orë mësimore në lëndën e artit pamor, të planifikuara 1 orë për çdo periudhë.
3. *Klasa/t pjesëmarrëse*: Klasa e X.
4. *Rezultatet e të nxënësve* – Në përfundim të projektit nxënësi:
 - ✎ Demonstron njohuritë e marra për grumbullimin e të dhënave mbi artin e realizmit socialist në Shqipëri sipas kontekstit historik dhe kulturor të ngjarjeve;
 - ✎ lexon dhe kupton të dhënat e grumbulluara mbi fushën e arteve në këtë periudhë;
 - ✎ interpreton të dhënat dhe konsolidon njohuritë mbi ngjarjet, përfaqësuesit dhe veprat;
 - ✎ krijon një album me vepra të artit duke i ndarë sipas gjinive dhe autorëve;
 - ✎ përdor terminologjinë e duhur artistike për të përshkruar, analizuar, dhe vlerësuar vepra të ndryshme të artit të realizmit socialist dhe të autorëve të ndryshëm;
 - ✎ bën lidhje ndërmjet njohurive të gjuhës artistike dhe përdorimit të tyre në veprat e artit të përfaqësuesve të ndryshëm;
 - ✎ prezanton para të tjerëve projektin për temën e dhënë, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
 - ✎ bashkëpunon me shokët për realizimin e projektit dhe kontribuon pozitivisht me grupin.
5. *Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit*:
 - 8.2 Grumbullimi i veprave të artit, qëllimi i studimit;
 - 8.3 grumbullimi i informacionit dhe të dhënave;
 - 8.4 përpunimi i informacionit dhe të dhënave;
 - 8.5 paraqitja grafike e të dhënave;
 - 8.6 interpretimi i të dhënave, klasifikimi i veprave për prezantim;
 - 8.7 prezantimi i tyre.
6. *Burimet kryesore të informacionit*:
 - ✎ Informacioni i marrë nga interneti, (kërkim mbi ngjarje, biografi dhe vepra arti).

☞ Informacion i marrë nga libra, albume dhe revista arti.

Baza materiale:

- Letra të bardha,
- kartonë,
- lapustila,
- Cd,
- foto,
- Dvd etj.,

7. Tematika e orëve të planifikuara:

- Ora 1.** Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.
- Ora 2.** Përpunimi i materialit të grumbulluar, zhvillimi i të dhënave nga kërkime të ndryshme, ppt etj..
- Ora 3.** Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij. Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve.

8.3.1 Përshkrimi i produktit të projektit

Projekti do të përmbajë krijimin e një historiku të periudhës së Artit të Realizmit Socialist në Shqipëri, bazuar në vepra dhe përfaqësues.

Për të realizuar këtë projekt nxënësit do të mbledhin informacione që lidhen me detyrën hulumtuese që ka secili grup. Detyra hulumtuese ka të bëjë me studimin e zhvillimit të artit figurativ gjatë periudhës së Realizmit Socialist në Shqipëri, veprat kryesore, format dhe gjinitë që u zhvilluan si dhe përfaqësuesit që lëvruan këto gjini dhe forma gjatë kësaj periudhe.

Gjatë këtij hulumtimi nxënësit nuk do të lënë pas dore, lidhjen e ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe në kontekstin politik, historik, artistik, etj.

Projekti do të shkruhet dhe prezantohet nga secili grup sipas formatit të caktuar më poshtë:

- Tema e projektit
- Rezultatet e të nxënit
- Tabela e planit të veprimtarive që ka realizuar secili grup me afatet dhe personat përgjegjës.

Kjo tabelë lidhet edhe me detyrat që ka realizuar secili anëtar i grupit. Një shembull table e planit të veprimtarive paraqitet më poshtë:

Faza e parë		
Veprimtaria që do të realizohet	Afati	Anëtari i grupit
Psh. Hulumtimi i ngjarjeve kulturore, politike, historike dhe artistike	15 tetor 201..	Anëtari
Psh. Hulumtimi i ngjarjeve artistike	20 tetor 201...	Anëtari
Interpretimi i të dhënave të gjetura	25 tetor 201...	Anëtari
.....		
Faza e dytë		
Psh. Grumbullimi i materialit nga burime të tjera	10 Janar 201..	Anëtari
.....		
Psh. Seleksionimi i të dhënave dhe përpunimi i materialeve	2 shkurt 201...	Anëtari
.....		
Faza e tretë		
Psh. Shkrimi i materialit	9 Mars 201..	Anëtari
.....		
Psh. Punimi i materialit në kompjuter	3 Prill 201...	Anëtari
.....		
Psh. Përgatitja e projektit për prezantim	15 Prill 201..	Anëtari ...
.....		

- Konceptet kryesore që janë përdorur gjatë zhvillimit të projektit.
- Përshkrim i shkurtër i projektit.

- Gjetjet e projektit. (*Gjetjet mund të paraqiten me mënyra të ndryshme: mund të shkruhen në një poster; mund të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen vetëm me gojë, mund të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik power point, nëse është produkt, prezantohet produkti etj.*)
- Konkluzione të projektit.

8.3.2 Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi

Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas tabelës 3 për vlerësimin e projekteve kurrikularë të përcaktuar sipas niveleve të mësipërme. Gjatë vlerësimit merret në konsideratë:

- Vetë orientimi dhe vetëdrejtimi i nxënësve në grup.
- Përdorimi i burimeve të ndryshme të mbledhjes së informacionit.
- Gjetja e zgjidhjeve në situata të ndryshme dhe arsyetimet intuitive.
- Përdorimi i saktë i koncepteve të artit pamor.
- Përzgjedhja e teknikave të përshtatshme pamore.
- Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit, individualisht dhe në progresin e grupit.
- Mënyra e prezantimit të projektit, i cili të lexohet, të dëgjohet dhe të kuptohet qartë.
- Rezultatet e projektit, nëse janë të qarta dhe të kuptueshme.

8.3.3. Vlerësimi i të nxënit të nxënësit realizohet nëpërmjet:

- a) Vlerësimit periodik,
- b) Vlerësimit përfundimtar.

8.4 Vlerësimi periodik

Vlerësimi periodik është dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të nxënësve për secilën periudhë. Ai përmban 2 (dy) nota:

- a) *Notën e vlerësimit të vazhduar,*
- b) *Notën e vlerësimit me detyrë përmbledhëse.*

Këto dy vlerësime me notë shënohen në regjistër në kolonat përkatëse.

8.5 Vlerësimi përfundimtar

- Vlerësimi përfundimtar realizohet me notë, në përfundim të vitit shkollor.
- Nota përfundimtare vjetore përmbledh notat vjetore si më poshtë:

Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudha.

	Pesha në përqindje klasat X-XII
Vlerësimi i vazhduar	40%
Vlerësimi me detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i projektit kurrikular	20%

Notën vjetore të vlerësimit me detyrë përmbledhëse për tri periudha.

Nota e vlerësimit të projektit.

Peshat në përqindje sipas vlerësimeve janë:

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare vjetore janë:

- Nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVv) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit të vazhduar të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Nota vjetore e vlerësimit me detyrë përmbledhëse (NTp/Dp) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit me detyrë përmbledhëse të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Nota e vlerësimit të projektit (NVp) përcaktohet në përfundim të projektit duke u bazuar në procesin e realizimit të projektit dhe në produktin përfundimtar.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse. Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 ≈ 9).
- Formulat për llogaritjen e notës përfundimtare janë:

Nota përfundimtare në klasat X-XII = (NVv x 0.4) + (NTp/Dp x 0.4) + (NVp x 0.2)

- Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënës sipas periudhave është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë <i>Shtator – Dhjetor</i>		Periudha e dytë <i>Janar - Mars</i>		Periudha e tretë <i>Prill - Qershor</i>		Vlerësimi vjetor			Nota përfundimtare
NVv	NTp/Dp	NVv	NTp/Dp	NVv	NTp/Dp	NVv	NTp/Dp	NVp	
6	6	8	7	8	7	8	7	9	8

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.8$$

Nota përfundimtare 8

OSE

$$(7 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.4$$

Nota përfundimtare 7

8.6. Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënit. Për këtë qëllim mësuesi duhet të përshtatë detyrat/veprimtaritë vlerësuese me mundësitë dhe nevojat që këta nxënës kanë. Këto modifikime mund të përfshijnë:

- Ndryshimin/përshtatjen e formateve alternative të pyetje/përgjigjeve, p.sh. një formë të përgjigjes më të thjeshtuar (bazuar në disa pika orientuese) në vend të një eseje që duhet të përgatisin nxënësit.
- Modifikime të veprimtarive vlerësuese, p.sh. duke thjeshtuar gjuhën e përdorur, ose duke përdorur një format tjetër të pyeturi.
- Përshtatje të procesit të vlerësimit, p.sh. duke i dhënë kohë shtesë nxënësit, me pauza të ndërmjetme, duke përdorur një lexues ose teknologji specifike.

Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

IX. KRITERET DHE REFLEKTIMI PËR DETYRA TË NDRYSHME NË LËNDËN E ARTIT PAMOR, AML

9.1. Kriteret për kryerjen e detyrave

Mësuesi duhet të përcaktojë kriteret vlerësimi për çdo detyrë dhe të sigurojë udhëzime të qarta për nxënësit se si do të jetë detyra e përfunduar dhe si do të zbatohen kriteret. Kur vendosni një detyrë sigurohuni që:

- kërkesat e detyrës janë bërë sa më qartë të jetë e mundur për nxënësin;
- kriteret e vlerësimit dhe nivelet e arritjes t'i ofrohen çdo nxënësi në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë;
- çdo burim ose material i përdorur të jetë i qartë dhe i përshtatshëm për detyrën;
- arritjet e nxënësit maten për më shumë se një rezultat të nxëni;
- udhëzimet të jenë të qarta dhe koncize;

- niveli i gjuhës të jetë i përshtatshëm për vlerësimin;
- detyra nuk përmban gjini, kulturë ose ndonjë paragjykim tjetër;
- koha e lejuar është e mjaftueshme për kryerjen e detyrës.

9.2. Reflektimi i mësuesit

Kur vlerësoni detyrën, mos harroni se reflektimet tuaja do të ndihmojnë nxënësin të kuptojë pse ai / ajo mori atë rezultat dhe si mund të bëhet më mirë herën tjetër.

Reflektimi duhet të jetë:

- konstruktiv në mënyrë që nxënësi të ndihet i inkurajuar dhe i motivuar për t'u përmirësuar;
- në kohë, në mënyrë që nxënësi ta përdorë atë për të mësuar në vazhdim;
- i menjëhershëm në mënyrë që nxënësi të mund të mbajë mend atë që bëri dhe të reflektojë në kohë;
- i fokusuar në arritje dhe përpjekje, jo te personi - puna duhet të vlerësohet, jo nxënësi;
- specifike për rezultatet e të nxënit në mënyrë që vlerësimi të jetë i qartë lidhur me të mësuarin.

Përgjigjet tuaja mund të jenë:

- informale ose indirekte - të tilla si reagimet verbale në klasë (me tërë klasën), ose në mënyrë individuale me vetë nxënësin.
- formale ose të drejtpërdrejta - të tilla si listat e kontrollit ose komentet për nxënësin në mënyrë individuale në formë të shkruar ose verbale;
- formative – të dhëna gjatë mësimit me qëllim ndihmës për nxënësin që të di se si të përmirësohet;
- përmbledhëse – të dhëna në fund të periudhës (ose të kapitullit) me qëllim informimin e nxënësve për çfarë kanë arritur.